

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

KUVENDI KOMUNAL-SKUPŠTINA OPŠTINE- MUNICIPAL ASSEMBLY

Anëtarit të Komitetit për Politikë dhe Financa
Z/znj _____

Në bazë të dispozitave të nenit 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bazë të dispozitave të nenit 41 të Statutit të Komunës së Novobërdës.

F T O J

Mbledhjen e nëntë të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet më :25.09.2024 (e mërkurë) duke filluar në ora 10:00.


R e n d i i d i t ë s

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Aprovimi i propozim buxhetit për vitin 2025-27;
3. Informim nga Drejtoria e Arsimit për fillimin e vitit shkollor 2024/25 (krahsimi i numrit të nxënësve nga viti 2023/24 në vitin 2024/25);
4. Raporti i Menaxhmentit të Ekologjisë për pagesën e mbeturinave për mergimtarët;
5. Informim rreth deponive ilegale në teritorin e Komunës se sa deponi janë pastruar deri më tani?;
6. Pruarja e vendimit për ndalim të perkoshëm për shqyrtim të kërkesave për ndryshim/destinim të tokave deri në aprovimin final të planit zhvillimor dhe urbanistik të Komunës;
7. Të ndryshme;

Mbledhja do të mbahet në hapësirat e K.K-së në Novobërdë.

Më:20.09.2024
Në: Novobërdë

Kryesues e Kuvendit
Mirjana Simijonović



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna e Novobërdës
Opština Novo Brdo - Municipality of Novo Brdo

ZYRA E KUVENDIT/KANCELARIJA SKUPŠTINE

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tetë e Kuvendit të Komunës së Novobërdës e mbajtur më datë 29.08.2024, duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja e Kuvendit znj. Mirjana Simijonovic, zv.kryesuesi i kuvendit zt. Ramush Mehmeti, antarët e Kuvendit: Stojan Stanojevic, Dragana Dimic, Pranvera Kastrati Gashi, Negovan Jovanovic, Abdyl Gashi, Selatin Nuhui, Dobrivoje Djordjevic, Vlora Vllasaliu, Stefan Kovacevic, Violeta Milosevic, Ivana Ivanovic, Ivica Cenec, DSHP Gafurr Vllasaliu, përfaqësuesi i OSBE-së, zyrtarë komunal dhe qytetarë.

Kryesuesja e Kuvendit pasi pershendeti të pranishmit tha: konstatoj korumin prezent janë 14 antarë nga 15 gjithësej, kemi korum për punë dhe vendimarrje dhe po fillojm mbledhjen me këtë:

R e n d i t e

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K-së;
2. Pruarja e vendimit për vazhdimin e Memorandumit të SH.Z.V në seli në Gjilan dhe K.K Novobërdë;
3. Raporti i drejtorisë së Bujqësisë mbi përfundimin e fushatës së korrjesirjeve;
4. Të ndryshme;

Kryesuesja tha: a keni ndonjë propozim për rend të dites?.

Pasi nuk pati propozime aprovohet njëzëri rendi i ditës.

Pika e parë: Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar e K.K;

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi nuk pati vërejtje procesverbali u aprovua njëzëri nga antarët prezent të Kuvendit.

Pika e dytë: Pruarja e vendimit për vazhdimin e Memorandumit të SH.Z.V në seli në Gjilan dhe K.K Novobërdë;

Kryesuesja për këtë pikë ja dha fjalën DSHP.

Gafurr Vllasaliu pasi pershendeti të pranishmit tha: te nderuar antarë të Kuvendit materialin e keni marrë me kohë, sipas raportit që e keni edhe ju para vetitë deri tani i kemi pasur 173 zjarre pra 173 intervenime që i bjen se çdo ditë kemi pasur nga një zjarr dhe vazhdimi i këtij memorandum është në dobi të qytetarëve të Komunës së Novobërdës, ne si Komunës të gjithë zjarrfikësit i kemi pajisur me të gjitha paisjet kohen e fundit, pasi që Komuna jonë është Komunë Kodrinore-malore kemi nevoj që fuqia puntore gjatë gjithë kohës të jetë në terren, nese keni ndonjë pyetje urdhëroni por edhe ju lus që ta votoni pasi që është në dobi të qytetarëve tonë, ju faleminderit.

Kryesuesja e hapi diskutimin për këtë pikë

Procesverbali i Kuvendit

Abdyl Gashi pasi pershendeti të pranishmit tha: edhe në KPF i kam shpreh pankaqësitbe mija, dhe perseri po mendoj se Kryetari dhe Drejtoria është duhur që më shumë të fukusohet në ngitje sigurim të pasijeve se rritje të stafit sepse puntorët pa paisje nuk mundë të intervenojnë dhe Komuna jonë po ka shumë nevoj të ketë paisje Kamioneta. Unë jam kunder vazhdimit të këtij memorandumi pasi që disa puntorë janë në shtëpi dhe marrin paga pa ardhë në punë fare dhe disa të tjerë që janë më larg njerezve zyrtarë ata anggazhohen dhe kryejn punët. Mendoj se duhet të ketë një barazi dhe një raport më të detajuar për punen të tyre, e di se kjo më shumë është bërë për përfitimin e votave nga të dy komunitetet.

Stojan Stonajovic pasi pershendeti të pranishmit tha: e respektojm mendimin e të gjithëve, duhet shumë të diskutojm dhe ne si antarë të Kuvendit duhet të ju sigurojm të ardhura por më mirë kishte me qenë që ti kemi këto kontrata me afat të pacaktuar.

Kryesuesja tha: këta zjarrfikës e kan jeten e tyre gjatë gjithë kohes në rrezik, andaj ne duhet ti përkrahim dhe ta rrisim numrin e tyre pasi që ka nevoj në Komunën tonë.

Pasi nuk pati diskutime tjera me 13 vota për 1 kunder (Abdyl Gashi) nga antarët prezent të Kuvendit aprovohet kjo pikë dhe mirret ky:

VENDIM

Pika e tretë: Raporti i drejtorisë së Bujqësisë mbi përfundimin e fushates së korrjeshirjeve;

Kryesuesja tha: nuk është askush që të prezantoj raportin, sigurisht se janë në terren pasi që me shkrim e kan sjell raportin, në KPF kanë qenë.

Pika e katërt: të ndryshme;

Kryesuesja e hapi diskutimin.

Pasi nuk pati diskutime Kryesuesja i falenderoi të pranishmit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:20.

Valmire Mustafa
Procesmbajtëse



Mirjana Simijonovic
Kryesuese e Kuvendit

